



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**V E N D I M**

**Nr. 482, Datë 31.07.2024**

**PËR**

**RENDITJEN E KANDIDATËVE NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË, NË FUSHËN E SË DREJTËS CIVILE TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 243, DATË 24.05.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me datë 31.07.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, përgatitur nga relatori i procedurës së përzgjedhjes z. Klodian Kurushi,

**V Ë R E N:**

**I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si Këshilli) pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji<sup>1</sup>, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës) dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1,

<sup>1</sup> Vendimi nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; Vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”; Vendimi nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; Vendimi nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”.

shkronja “a”, i Kushtetutës), në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ndër të tjera, ka hapur dhe pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, me Vendimin e saj nr. 243, datë 24.05.2023.

2. Në procedurën e ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë të hapur me Vendimin e Këshillit nr. 243, datë 24.05.2023, aplikoi disa kandidatë, por në kohën e vendimmarrjes mbi fillimin e procedurave të verifikimit për këtë pozicion, në përfundim ishte një kandidat<sup>2</sup>, konkretisht znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2.1 Ndërkohë, kandidatja znj. {...} ka kandiduar edhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 239 dhe nr. 240 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në fushën e së drejtës civile, për të cilat vijonë procedurat.

3. Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve *që përmbushin kriteret*, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë.

4. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Këshilli realizoi procedurën e verifikimit të plotësimit, në rastin konkret për të vetmin kandidat, të kriterëve të mëposhtme:

- 1) *“përvojës profesionale minimale”*, sipas shkronjës “b”, pika 4, të nenit 47, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“4. “Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*;
- 2) *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*, sipas pikës 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“8. Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*;

---

<sup>2</sup> Referuar arsyetimit të Vendimit nr. 57 datë 07.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246 dhe nr. 247 datë 24.05.2023 dhe Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 235, 236, 237 dhe 238 datë 24.05.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- 3) *“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”*, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e kësaj neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e saj deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cënuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të kësaj neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të kësaj neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të kësaj neni. ...”*;
- 4) *të pasurisë dhe figurës*, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të kësaj ligji”*, si dhe: *“8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”*.

5. Kështu, për kandidaten e vetme, znj. {...}, Këshilli verifikoi plotësimin nga ajo të kriterëve të kandidimit dhe me Vendimin nr. 395, datë 29.07.2024 vendosi kualifikimin e saj dhe vijimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për tre pozicionet e lira ku ajo ka kandiduar.

6. Ndërkohë, krahas procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht, për kandidaten kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht:

- 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin;
- 2) vlerësimi i përsheptuar për vitin 2022, referuar nenit 97, të Ligjit për Statusin;

7. Me kualifikimin e kandidates znj. {...}, bazuar në pikën 24, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), Këshilli, me Vendimin nr. 425, datë 30.07.2024, filloi procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e saj nr. 243, datë 24.05.2023. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes u caktua anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Klodian Kurushi.

8. Më datë 30.07.2024, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit 70/2020, kandidatja e kualifikuar u njoftua për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë ku ajo kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatja nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesë për përjashtimin e relatorit, apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

9. Në zbatim të shkronjës “a”, pika 47, të Vendimit 70/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës të kandidatës, që gjendej në dosjen e saj personale apo në praktikën dokumentare të procedurës së verifikimit të plotësisht të kriterëve të kandidimit. Po ashtu, relatori administroi edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për të.

10. Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidaten e vetme znj. {...}, u konstatua se:

Sipas Vendimit të Këshillit nr. 259, datë 16.05.2024, kandidatja është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*”, duke grumbulluar në total 374 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim;

Sipas Vendimit të Këshillit nr. 396, datë 30.07.2024, kandidatja është vlerësuar për vitin 2022, në nivelin e përgjithshëm “*Shkëlqyeshëm*”, duke grumbulluar në total 383 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

11. Dy vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatjat znj. {...} të miratuara me Vendimet e Këshillit nr. 259, datë 16.05.2024 dhe nr. 396, datë 30.07.2024, u konstatua të jenë bërë përfundimtarë, ndërsa ndaj tyre nuk është paraqitur ankim referuar deklaratës së kandidatës të dërguar në rrugë elektronike, protokolluar në Këshill me datë 30.07.2024, përmes të cilës është shprehur se pasi u njoh me vendimet e Këshillit, deklaroi se nuk ka ankim ndaj tyre.

12. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në kushtet kur në këtë procedurë ngritjeje në detyrë ka kandiduar vetëm një kandidat dhe, për rrjedhojë, edhe në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve është vetëm një i tillë, u vlerësua se nuk ka vend për ndjekjen e hapave, kriterëve dhe përparësive sipas përcaktimeve të Kreut IV, të Vendimit 70/2020, në funksion të renditjes së kandidatëve. Nga ana tjetër, në respektim të përcaktimeve të Seksionit B, Kreu VI, të Vendimit 70/2020, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

## **II. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

13. Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Seksionin Ç, Kreu VI, të Vendimit 70/2020.

14. Gjatë shqyrtimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar për kandidatët në funksion të renditjes së tyre.

## **III. KONKLUZIONI**

15. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

## **PËR KËTO ARSYE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 10 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”,

## **V E N D O S I:**

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:
  1. Znj. {...}
  2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**